



UNIVERSITETI I MITROVICËS

UNIVERSITY OF MITROVICA

“ISA BOLETINI”

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Dt. 01.09.2016

Shpallje

Bazuar në nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, bazuar në vendimin nr. 289 i datës 07.03.2016 të Këshillit Drejtues të Universitetit, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”, kërkon të angazhoj me afat të caktuar, një (1) Ekspert të fushës për Planifikim Strategjik.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Eksperti në hartimin e Planit Strategjik do të mbështetë profesionalisht Këshillin Drejtues, në mënyrë që në pajtim me nenin 22 pika 1.2 dhe 1.3 të Statutit të Përkohshëm të UMIB, KD të nxjerr Planin Strategjik.

Shkathtësitë e kërkua: *(Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

- Diplomë universitare e studimeve master ose doktoratë;
- Përvojë e mëparshme e punës në lidhje me hartimin e Planeve strategjike dhe strategjive zhvillimore në përgjithësi;
- Dëshmi të trajnimeve, të përfunduara nga fusha e Planit Strategjik
- Njohja e mirë e programeve të Teknologjisë Informativë që përshtaten me këtë vend pune;
- Preferohet njohja e gjuhës Angleze dhe ndonjë gjuhë tjetër.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Universiteti i Mitrovicës – Rektorati/Zyra e personelit ose mund të shkarkohen në ueb-faqen <http://umib.net>

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni Zyrën e Personelit prej orës 8:00 – 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: **01.09.2016 deri më 08.09.2016**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e e arritura pas afatit dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet.

Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit.

